



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PËRFAQËSUESVE TË AGJENCISË SË LAJMEVE "ANADOLU
AGENCY"(AA) NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 21.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i gazetarëve të paraqitur nga agjencia e lajmeve "Anadolu Agency" (AA) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

Agjencia e lajmeve "Anadolu Agency" (AA) me aktivitet në fushën e medias ka paraqitur kërkesën e tij me nr.Prot 11828 të datës 17.06.2019, bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.



Nr. 841 i Vendimit

Data 21 .06.2019

Ora 10 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e gazetarëve të paraqitur nga agjencia e lajmeve "Anadolu Agency" (AA) për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30

Qershor, 2019

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën Agjencisë së lajmeve "Anadolu Agency" (AA) për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.4, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 841 i Vendimit

Data 21 .06.2019

Ora 10 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e gazetarëve të paraqitur nga agjencia e lajmeve "Anadolu Agency" (AA) për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30

Qershor, 2019